

IDEAL Ju falenderon!

Rellinghauser Str. 22
45128 Essen

Tel.: + 49 (20 1) 75 99 85 28
Fax: + 49 (20 1) 75 99 85 29
E-Mail: info@i-de-al.org
Web: www.i-de-al.org

Amtsgericht: Essen VR 5251
Steuernr.: 112/5870/1294

Bankverbindung: Postbank
Kontonr.: 999 44 64 35
BLZ: 360 10 0 43

Präsidentin: Anduena Stephan
Vertretung: Alban Shehu

Essen, am 20.04.2015

DitëDialogu NRW – Tiranë, Mesazhe & Përshtypje

Landi gjerman NRW – Shumë arsye për ta afruar si investitor në Shqipëri

Investimet e huaja mbeten jetike për rritjen ekonomike të Shqipërisë. Lidhur ngushtë me stabilitetin politik, rritja ekonomike përcakton në fund të fundit edhe ritmin e afrimit të Shqipërisë me BE. Shqipëria është një vend i vogël në Ballkan, por një vend që ka nënshkruar marrëveshjen e tregtisë së lirë CEFTA, e cila e ngre tregun në nivelin e 26 milionë konsumatorëve. Interesi i investitorëve gjermanë për të investuar në Shqipëri dhe i investitorëve shqiptarë për të bashkëpunuar me kompani gjermane ka ardhur ndërkohë duke u rritur shumë. Këtu bën pjesë edhe Landi gjerman NRW, i cili mbahet si një nga zonat kyçe të industrisë dhe një nga qendrat kryesore ekonomike të Gjermanisë.

Ky Land arriti në vitin 2012 një prodhim të brendshëm bruto prej 582,1 miliardë Euro. **Landi i Renanisë Veriore-Vestfalisë** me 17,5 milionë banorë zë vendin nr.1 të investimeve gjermane dhe është një nga tregjet më të mëdha evropiane. NRW mbahet edhe si vendi nr.1 i



Unternehmerreise nach Albanien und Kosovo

unter Teilnahme von NRW-Staatssekretär
Dr. Günther Horzetzky

Tirana und Pristina
25. bis 28. März 2015

Außenwirtschaftsförderung für Nordrhein-Westfalen
www.nrw-international.de



panaireve tregtare në mbarë botën. Volumi i tregtisë arrin në 385 miliardë euro. NRW përbën 22% të fuqisë blerëse gjermane dhe është një prej vendeve më të pasura me peizazhe kulturore dhe argëtuese. Ky land është vendi kyç në botë, pasi 16 nga 50 kompanitë më të mëdha në Gjermani e kanë selinë e tyre në këtë land.



Për këtë arsye në Tiranë u zhvillua javën e kaluar Tryeza e Rrumbullakët “**Ditët e dialogut Shqipëri-NRW**”, në kuadër edhe të vizitës së tij të parë në Shqipëri të Sekretarit të Shtetit për Ekonominë, Energjinë, Bizneset e Mesme dhe Profesionet e Landit të Renanisë Veriore- Vestfalisë, **Dr. Günther Horzetzky**. E organizuar nga Ambasada Gjermane në Tiranë në bashkëpunim me Konsullën e Nderit të Shqipërisë në Esen, **zonja Anduena Stephan** si dhe nga Shoqata Integrative Gjermano-Shqiptare, IDEAL, në këtë aktivitet ishte i ftuar Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, z. Arben Ahmetaj dhe një numër përfaqësuesish të lartë të institucioneve dhe bizneseve nga të dy vendet. Temë kryesore ishte bashkëpunimi bilateral mes landit NRW dhe Shqipërisë, mes Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, projekte të përbashkëta në fusha prioritare si industria e minierat apo dhe turizmi e tregtia e produkteve të industrisë së lehtë dhe ushqimore, angazhimi i diasporës shqiptare të këtij Landi në transferimin e eksperiencës unike që posedon ky land në sektorët e mësipërm.



Në fjalën e tij **ministri Ahmetaj** përmendi reformat që qeveria shqiptare ka ndërmarrë dhe po vazhdon të bëjë në sistemin energjetik, pensione, kuadri makroekonomik e fiskal, territoriale-administrative dhe ajo mbi klimën e biznesit me qëllim zhvillimin e një ekonomie të qëndrueshme dhe afatgjatë. Ministri u ndal gjithashtu në aspektin rajonal me qëllim bashkëpunimin për krijimin e një tregu



rajonat të integruar dhe konkurrues. Duke folur për bashkëpunimin dypalësh Ministri ftoi investitorët gjermanë të vijnë në Shqipëri për të përfituar nga mundësitë që vendi ofron në këtë moment në shumë sektorë. Ministri përmendi ligjet e **investimeve strategjike**, turizmit dhe zonave të lira ekonomike, për të cilat premtoi një paketë tejet konkurruese dhe ambicioze për investitorët.



„Të vetëm jemi dy apo tre milionë konsumatorë, ndërsa të integruar në rajon, të hapur me tregun e **Bashkimit Evropian**, ne jemi 26 milionë konsumatorë dhe sigurisht që kthehemi në një treg më interesant dhe më atraktiv për investimet gjermane dhe për gjithë investimet e huaja. Shqipëria ka marrë rol jashtëzakonisht aktiv në bashkëpunimin rajonal për të paraqitur në Vjenë (në Konferencën e ardhëshme pas Berlinit në gusht 2014) një hartë të konsoliduar, të përpunuar bashkërisht me Kosovën, me Serbinë, me Malin e Zi, me Kroacinë dhe me Maqedoninë. Frytet e para për Shqipërinë, sigurisht edhe për rajonin e për disa vende të tjera të **Bashkimit Evropian**, janë paraqitur edhe pas diskutimeve të fundit me Komisionin“, theksoi Ahmetaj. Ai ftoi biznesin gjerman për të investuar duke iu referuar tenderit për zonën e lirë ekonomike që do të hapet pas një muaji në Spitalë.



Ndërsa **z. Günther Horzetzky** vlerësoi mundësitë e shumta për bashkëpunim me Shqipërinë dhe nevojën për t'i shtrirë ato në sektorë të rinj. “Shanset janë shumë pozitive. Produkti i brendshëm bruto i landit Renani Veriore-Vestfali është rreth 600 miliardë euro. Ne importojmë produkte të manufakturës, tekstile dhe këpucë, lëndë kimike e plastike etj nga Shqipëria, por ne besojmë se mundësitë janë të dukshme në shumë sektorë të tjerë”, tha Sekretari i Shtetit. Ai ofroi mbështetjen për krijimin e urave lidhëse dhe të komunikimit mes



bizneseve në të dy vendet dhe inkurajoi investitorët gjermane të vijnë në Shqipëri.

Ambasadori i Republikës Federale në Tiranë, **Z. Hellmut Hoffmann** duke përshëndetur këtë Tryezë-Dialogu theksoi ndër të tjera: “Shqipëria ka një sërë potencialesh ekonomike por ka nevojë që të përmbushë edhe një sërë detyrash”.

Anduena Stephan, Presidente e Shoqatës IDEAL- Esen

Themelet e një bashkëpunimi më të gjerë ekonomik gjermano - shqiptar veçanërisht me landin NRW u hodhën qysh në nëntorin e vitit 2013, kur në qytetin e Esenit u zhvillua Konferenca e parë ekonomike gjermano - shqiptare. Kjo Konferencë u mbajt me iniciativën e Shoqatës Integrative Gjermano - Shqiptare, IDEAL - nën drejtimin e zonjës Anduena Stephan, e cila si bashkëorganizatore e këtij Dialogu, u ndal në rëndësinë e angazhimit të këtij Landi, por mbi të gjitha të Diasporës së sotme në Gjermani që është një kapital që duhet shfrytëzuar: „**Bizneset e diaspores** kontribuojnë mbi 3 miliardë Euro në GDP e Landit, punësojnë me qindra qytetarë të tij, ofrojnë mundësi praktikash e trajnimi nga më të ndryshmet dhe janë model i integritimit në këtë land, sepse integrimin e ka një nga pikat e tij më të forta“, – thotë ajo. „Por ky potencial është shfrytëzuar shume pak ose aspak nga Shqipëria dhe Kosova, programet dhe projektet mungojnë. Pikerisht për këtë, Shoqata IDEAL dhe **Konsullata e Nderit e Shqiperisë në NRW** iniciuan këto **Ditë Dialogu** me institucionet më të rëndësishme të Landit, nën shoqërimin e shoqatave më të fuqishme ekonomike gjermano shqiptare aktive në të”, thekson zonja Stephan.

Në ambjentet e Ambasadës gjermane në Tiranë, zoti Horzetzky u takua edhe me ministrin e Bujqësisë, **zotin Edmond Panariti** dhe



zhvilloi një tryezë pune edhe në Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe të Punës në praninë e **z. Erjon Veliaj**.

Kontributet gjermane për Shqipërinë që nga viti 1990 arrijnë në një total prej më shumë se 1 miliard euro. Të gjitha projektet e bashkëpunimit bilateral kanë për qëllim anëtarësimin sa më shpejt të Shqipërisë në BE dhe forcimin e bashkëpunimit duke vënë diasporën si urë më optimale lidhëse për forcimin e këtij bashkëpunimi në qendër të tij. **”Ditë Dialogu”** ishte hapi i parë drejt një bashkëpunimi më konkret në të ardhmen me shpresë se Landi NRW do ketë mundësinë të jetë më shumë i pranishëm në Shqipërinë e vogël, por që strategjikisht është mjaft e madhe në rajonin juglindor të Evropës.

Pergatitur nga Mimoza Kelmendi (Media/Komunikim)



Partneret e IDEAL -



Honorarkonsulat der Republik Albanien in NRW
Konsullata e Nderit e Republikës së Shqipërisë në NRW

